

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

26.04.2023
Ora, 12:14

RENDI I DITËS

Projektvendim “Projektvendim “Për miratimin e rregullave procedurale teknike për administrimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor të votimit dhe numërimit elektronik në Bashkitë Vorë, Kamëz dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. V. Ballgjini,
Znj. I. Osmanaj.**

• **Parti Politike:**

BF

• **Të tjerë:**

**KRIIK, OSBE\ODIHR, Qëndresa Qytetare,
Komiteti Shqiptar i Helsinkit.**

Z. I. Celibashi: Mirëdita, ndjesë për vonesën! Në seancën e sotme kemi në rend dite Projektvendim “Për miratimin e rregullave procedurale teknike për administrimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor të votimit dhe numërimit elektronik në Bashkitë Vorë, Kamëz dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Kemi vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 14 Prill – 20 Prill 2023, dhe shqyrtimin administrativ të denoncimeve me nr. 229, 287, 290, 294, 295, 299, 300, 301, 302, 303, 304, 306, 308, 314, 318, 319, 320, 321, 322, 324, të Regjistrit të KQZ-së, paraqitura nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

Institucione të Konsoliduara, bashkë me denoncimet nr. 335, 336, 337, të “Qendresa Qytetare”, të denoncimeve nr. 338, të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, të denoncimeve nr. 327, 328, 329, 330, 331, 332, 333 dhe 334. Pika e tretë lidhet me Shqyrtim e denoncimit me nr. 386 të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për vendosje materiali propagandistik në Bashkitë Rrogzhinë, Kavajë, Lushnjë dhe Durrës. Pastaj kemi Shqyrtimin e denoncimit me nr. 387 të Partisë Socialiste të Shqipërisë ndaj subjektit zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për vendosje materiali propagandistik në Bashkinë Kavajë. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës “Për miratimin e rregullave procedurale teknike për zhvillimin e procesit të numërimit elektronik në Bashkitë Vorë, Kamëz dhe Elbasan”.

Z. Y Merkaj: Po faleminderit! Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 17, dt. 13.04.2023 ka miratuar rregullat procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit PEVN, për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Referuar nenit 19, pika 1, të Kodit Zgjedhor si dhe nenit 17 të sapo cituar, kemi përgatitur projektvendimin për miratimin e rregullave procedurale teknike për administrimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor të votimit dhe numërimit elektronik në bashkitë Vorë, Kamëz dhe Elbasan. Qëllimi i këtij projektvendimi është të përcaktojë rregullat procedurale teknike për procesin e numërimit dhe votimit elektronik nëpërmjet pajisjes PEVN në QV-të Elbasan, Kamëz dhe Vorë. Rregullat janë grupuar në dy pjesë. Pjesa e parë ka të bëjë me votimin dhe rregullat që përdoren dhe procedurën që përdoret nga KQV-të ditën e votimit dhe pjesa e dytë është procedurat që përdoren në VNV dhe marrjen në dorëzim nga KZAZ-ja të pajisjes PEVN. PEVN

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

ku kryhet votimi shoqërohet me një kuti të pajisur me printer që mundëson versionin fizik të ruajtjes së votës dhe ka dy memorje në USB dhe një backup ku shkon elektronikisht vota që hedhim dhe votat për zgjedhësit. Kutia shoqëruese do të ketë 3 kode sigurie, të cilat vendosen ditën e votimit dy në pjesën anësore dhe një tek dritarja e printerit. Operatori teknik i ngarkuar për përdorimin e PEVN-së nëpërmjet kartave smart dhe kodeve përkatëse bën hapjen e PEVN-së duke printuar dhe dorëzuar në KQV raportin e hapjes së votimit, i cili do të tregojë veç orës së hapjes numrin e QV-së, pajisjen dhe 0 pjesëmarrës në votim. Gjithashtu është parashikuar dhe procedura që kryhet nga anëtari i KQV-së për aktivizimin për votim të dy pajisjeve PEVN në çdo QV nëpërmjet butonit tip pulsant. Janë parashikuar dhe procedurat që kryen votuesi gjatë votimit nëpërmjet pajisjes PEVN ku në ekran pasqyrohet vota, ekrani është më prekje dhe votuesi shikon përpara së të votojë e shikon në ekran sesi hidhet vota dhe nëpërmjet butonit konfirmo, konfirmon votën që hedh sipas dëshirës së tij. Gjithashtu kemi parashikuar dhe rastet se si procedohet kur votimi elektronik nuk mund të fillojë ose është ndërprerë për arsye teknike. PEVN-ja është parashikuar të punojë në mënyrë të pavarur nga energjia elektrike për 12 orë. Gjithashtu në përfundim të procesit të votimit pasi Komisioni i Qendrës së Votimit ka marrë vendimin për mbylljen e votimit, i kërkohet operatorit teknik të kryejë mbylljen e procesit të votimit në pajisjen PEVN, si dhe printimin e raportit të mbylljes së votimit. Raporti i mbylljes së votimit do të përmbajë veç të dhënave të QV-së edhe numrin e zgjedhësve që kanë votuar dhe do të printohet në 8 kopje dhe të firmoset nga anëtarët e komisionit të qendrës së votimit. Në lidhje me pjesën e dytë që është numërimi, kemi parashikuar procedurat që kryen komisioni i ZAZ-së për marrjen në dorëzim të pajisjes PEVN, ku KZAZ-ja cakton një ose dy më shumë grupe të marrjes në dorëzim. Grupet e marrjes në dorëzim përbëhen nga dy anëtarë të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

KZAZ-së me përkatësi të ndryshme politike si dhe procedurat që kryhen për marrjen në dorëzim të pajisjes PEVN. Gjithashtu është parashikuar që pajisja PEVN do të merret në dorëzim dhe kryhen të njëjtat procedurat si në rastin e kutive me fletët e votimit ku parashikohet cilat janë të rregullta dhe të parregullta. Në përfundim të procesit të marrjes në dorëzim plotësohet procesverbali i marrjes në dorëzim të materialit zgjedhor nga KQV-të përkatëse. Gjithashtu PEVN-të dhe kutitë shoqëruese të votimit të përcaktuara si kuti të parregullta në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk mund të futen në procesverbalin e nxjerrjes së rezultatit nga KZAZ-ja. PEVN-të dhe kutitë shoqëruese të votimit së bashku me kutitë dhe materialet e votimit renditen sipas numrit të QV-së. QV-të renditen sipas rendit rritës së tyre. E para në rradhë duhet të jetë QV-ja me numër rendor më të vogël dhe e fundit QV-ja me numër rendor më të madh. QV-të bija vendosen menjëherë pas QV-së mëmë. KZAZ-ja pasi sigurohet që janë marë në dorëzim të gjitha kutitë e votimit merr masat paraprake për fillimin e procesit të numërimit të votave. KZAZ-ja merr vendim për fillimin e procesit të nxjerrjes së rezultatit pasi ka marrë në dorëzim të gjitha PEVN-të, kutitë shoqëruese të votimit, fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit në të gjitha QV-të që ka nën juridiksionin e saj. Kryerja e procedurave për verifikimin paraprak me vendimin e fillimit të nxjerrjes së rezultatit shënohet ora e saktë e fillimit të procedurës së nxjerrjes. Gjithashtu kryhet procedura për veprimet paraprake të rëndësishme dhe ora e fillimit të procesit të nxjerrjes së rezultatit shënohen në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së. Është parashikuar detyra e sekretarit të KZAZ-së, i cili për nxjerrjen e rezultatit ndjek procedurat e parashikuara në këtë projektvendim. Sekretari i KZAZ-së vendos mbi tryezën e PEVN-së e cila ka kartat e memories të vendosura nga KQZ-ja dhe hap atë duke këputur vulën me kodin e sigurisë dhe tekniku i kontraktuar nga KQZ-ja vet ose duke u asistuar nga anetari i KZAZ-së nxjerr nga

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

pajisja një nga memoret usb të PEVN-së. Sekretari i KZAZ-së i kërkon teknikut të vendosë në sistemin EMS, EMV memorien usb për nxjerrjen e rezultatit për subjektet dhe për kandidatët. Sistemi nxjerr rezultatin, tabelën e rezultateve për QV-të dhe për kandidatin. Pas nxjerrjes së rezultatit të QV-ve nga sistemi karta e memories vendoset në folenë përkatëse të PEVN-së dhe vulozet me vulë dhe kode të reja sigurie, të cilat shënohen në tabelën e rezultateve. Menjëherë pas fillimit të procesit të numërimit të votave si dhe më sipër të gjitha QV-ve sekretari i KZAZ-së kërkon nga operatori të printojë nga sistemi SEMVR tabelën me rezultatin për ZAZ-në në të cilën pasqyrohet rezultati për çdo kandidat. KZAZ-ja dërgon në rrugë elektronike për çdo QV informacionin mbi rezultatet e zgjedhjeve sipas tabelave të rezultateve të QV-ve për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët, menjëherë pas miratimit të tabelave përmbledhëse për rezultatin për ZAZ-në. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësues të partive politike në lidhje me këtë projektakt? Jemi dakord. Mire atëherë, miratojmë projektaktin sipas draftit të propozuar nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr. 415

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

26.04.2023
Ora, 12:25

RENDI I DITËS

Projektvedndim “Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 14 Prill – 20 Prill 2023, dhe shqyrtimin administrativ të denoncimeve me nr. 229 ID, 287 ID, 290 ID, 294 ID, 295 ID, 299 ID, 300 ID, 301 ID, 302 ID, 303 ID, 304 ID, 306 ID, 308 ID, 314 ID, 318 ID, 319 ID, 320 ID, 321 ID, 322 ID, 324 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, të denoncimeve nr. 335 ID, 336 ID, 337 ID, të Qendrës “Qendresa Qytetare”, të denoncimeve nr. 338, të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, të denoncimeve nr. 327 ID, 328 ID, 329 ID, 330 ID, 331 ID, 332 ID, 33 ID, 334 ID, që lidhen me këtë periudhë monitorimi”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. V. Ballgjini,
Znj. I. Osmanaj.**

• **Parti Politike:**

BF

- **Të tjerë: KRIIK, OSBE\ODIHR, Qëndresa Qytetare, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, përfaqësuesit e bashkive Dimal, Fusharrëz.**

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës që ka të bëjë me vlerësimin e raportimit të institucioneve publike për periudhën 14 prill- 20 prill, së bashku me denoncimet që kanë sjellë Organizata KRIIK, “Qëndresa Qytetare” dhe Komiteti Shqiptar Helsinkit për veprimtarinë e institucioneve publike për këtë periudhë.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

Znj. I. Osmanaj: Për periudhën e raportimit, për datat 14 prill deri në 20 prill 2023 në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike të KQZ-së janë raportuar shkresërisht dhe nëpërmjet emailit 209 aktivitete nga 51 institucione publike. Nga verifikimi paraprak rezulton se nga çdo 4 aktivitete të zhvilluara në 4 institucione janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Jemi ende në proces shqyrtimi administrativ. Ndërkohë sjellim në vëmendje që KQZ-ja po monitoron në baza ditore veprimtaritë e raportuara me vonesë për respektimin e afatit 5 ditor të raportimit dhe veprimtaritë me pjesëmarrjen e personave partiakë. Nga këto veprimtari janë ndaluar në total deri tani 37 veprimtari publike nga të cilat 19 veprimtari janë ndaluar për shkak të pjesëmarrjes së personave partiakë dhe 18 veprimtari për mosrespektim të afatit të raportimit. Njëkohësisht gjatë kësaj periudhe janë caktuar monitorues për 104 veprimtari të institucioneve të ndryshme shtetërore për të vëzhguar nëse këto aktivitete do të mbahen duke respektuar dispozitat e kodit ligjor zgjedhor dhe nëse prezenca e deputetëve do të krijojë mundësinë për politizimin e këtyre aktiviteteve si dhe nëse do të mbahen fjalimet që ata mbajnë apo përdorin material propagandistike. Njëkohësisht për këtë periudhë raportimi, për datën 14 prill - 20 prill ne kemi administruar denoncime të përcjella nga KRIIK-u, nga organizata "Qëndresa Qytetare", nga Helsinki sikurse dhe nga subjekte zgjedhore. Këto denoncime kryesisht kanë të bëjnë me mosraportimin e veprimtarive publike në faqen e dedikuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për këtë qëllim. Kanë të bëjnë me përdorimin e burimeve dhe aseteve publike dhe veprimtari publike me pjesëmarrjen e deputetëve duke përdorur njëkohësisht edhe slogane. Janë administruar denoncimet për Bashkinë Cërrik, për Bashkinë Berat, Devoll, Dimal, Belsh, Elbasan, Mallakastër, Himarë, Fusharrëz, Tiranë, Shkodër dhe Berat për kryerje veprimtarish të paraportuara në ndërfaqen e KQZ-së. Për sa i takon Bashkisë

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

Cërrik është bërë një denoncim nga KRIIK-u nëpërmjet së cilës denoncohet kryrja e një veprimtarie të zhvilluar përpara datës së raportuar. Denoncimi është regjistruar me numër regjistri 321 ID. Objekti i denoncimit ka të bëjë me inspektimin e punimeve për rehabilitimin e rrugëve në lagjen Dyrma dhe *(nuk kuptohet qartë)*. Pretendimet e KRIIK-ut janë që Bashkia Cërrik ka raportuar në ndërfaqen e KQZ-së në datën 10 prill inspektim në kantjerin e infrastrukturës publike për tu zhvilluar në datën 15 prill. Ky aktivitet është publikuar në faqen e Bashkisë Cërrik në datën 8 prill. Struktura përgjegjëse ka vijuar hetimin administrativ duke i ka dërguar kërkesë për informacion personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Cërrik. Kemi administruar pretendimet e Bashkisë Cërrik ku bëhet me dije se kemi raportuar në ndërfaqen e raportimeve në datën 2 prill veprimtarinë me temë “Inspektim në kantierin e infrastrukturës publike”, për tu zhvilluar në datën 7 prill dhe është pasqyruar në faqen Facebook të nesërmen. Kaq administrojmë si përgjigje nga Bashkia Cërrik. I kemi thirrur për të marrë pjesë sot në seancën publike por rezulton se nuk janë paraqitur në këtë seancë. Kemi Bashkinë Berat për dy veprimtari publike të paraportuara, të regjistruara me numër regjistri 318 dhe 319 ID. Denoncuesi përkatësish KRIIK-u denoncon 2 veprimtari. Objekt i këtyre veprimtarive është takimi i kryetarit të Bashkisë zotit Ervin Demo me banorë të zonës të rajonit 3. Takimi i dytë është takimi i Kryetarit të Bashkisë zotit Demo sërisht me pensionist të zonës së rajonit 3. Në kuadër të procedurës administrative kemi dërguar kërkesë për informacion dhe në përgjigje kemi marrë pretendimet e Bashkisë Berat ku bëhet me dije se Bashkia Berat ka raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, në datën 2 prill një aktivitet për tu zhvilluar në datën 7 prill me objekt takim me banorët e lagjes Uznovë, ku bën pjesë dhe rajoni 3. Dy takimet objekte denoncimi janë zhvilluar brenda së njëjtës ditë, në datën 7 prill. Janë njoftuar palët për të marrë pjesë në seancën e sotme publike por rezulton që nuk i janë përgjigjur kërkesës sonë

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

për të paraqitur edhe pretendimet përfundimtare. Bashkia Devoll është denoncuar për një veprimtari publike të paraportuar me numër regjistri 287 ID, me objekt takimin e Kryetarit të Bashkisë Devoll zotit Duro me komunitetin e Villbohovës, me rastin e përmirësimit të infrastrukturës së ujit të pijshëm. Kemi dërguar kërkesë për informacion personit përgjegjës, ku në përgjigje të kërkesës sonë ka sjellë pretendimet e tij dhe shkresërisht dhe nëpërmjet emailit ku ndër të tjera bën me dije se ky aktivitet nuk është veprimtari publike e organizuar nga bashkia, por është një aktivitet politik elektorale i organizuar pas orarit zyrtar të punës. Është lehtësisht e dukshme që dhe organizimi i tyre është bërë në ambiente private dhe jopublike apo ambiente në varësi të Bashkisë Devoll. Nuk ka patur përdorim të burimeve publike. Nuk ka patur logo apo simbole të ngjashme të institucioneve publike, si dhe nuk ka patur pasqyrim të asnjërës prej këtyre veprimtarive në faqen zyrtare të bashkisë apo të jetë publikuar në profiling zyrtar të kryetarit të Bashkisë Devoll. Këto aktivitete janë të pasqyruara vetëm në profiling personal të Kryetarit të Bashkisë Devoll. I kemi thirrur palët për të marrë pjesë në seancën e sotme publike për të dhënë edhe pretendimet e tyre përfundimtare por rezulton se nuk janë paraqitur në këtë seancë publike. Kemi Bashkinë Dimal, e denoncuar për një veprimtari publike të paraportuar, e regjistruar me numër regjistri 290 ID. Objekt i këtij denoncimi është takimi i Kryetarit të Bashkisë Dimal, zonjës Juliana Memaj me komunitetin në Syzezë, me rastin e nisjes së punimeve për rrugën lidhëse mes Syzez-it dhe Malas-Gropë. Kemi dërguar kërkesën për informacion personit përgjegjës për Bashkinë Dimal. I është përgjigjur emailit tonë duke bërë me dije se ky aktivitet nuk është organizuar nga Bashkia Dimal por është një aktivitet politik i organizuar nga Kryetarja e Bashkisë në cilësinë e kandidatit si figurë politike dhe si i tillë është publikuar vetëm në faqen e saj personale. Kemi bërë njoftimin për të marrë pjesë në seancë publike dhe rezulton se përfaqësuesi i Bashkisë Dimal është në seancë.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

Z. I. Celibashi: Po fjala është për ju.

Znj. Rajmonda Shukra, Sekretare e Përgjithshme e Bashkisë Dimal: Rajmonda Shukra, Sekretare e Përgjithshme e Bashkisë Dimal. I Nderuar zoti Komisioner referuar hetimit administrativ me kërkesë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve paraqesim kundërshtimet tona të cilat i kemi paraqitur edhe në adresë elektronike si më poshtë vijon. Referuar përkufizimit të veprimtarive publike ne kemi cituar një ndarje të qartë si është e parashikuar edhe në dispozitat e vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9, datë 21.12.2020, pra për një ndarje të qartë të veprimtarive elektorale të një natyre personale të veprimtarisë së kandidatit, të konfirmuar nga partitë politike. Pra veprimtarive të lidhura ngushtësisht me figurën e kryetarit si kandidat. Për sa i përket përkufizimit të veprimtarive publike theksojmë se Njësia e Vetëqeverisjes Vendore ka detyrimin të raportojë pranë KQZ-së vetëm aktivitetet publike ku bashkia është organizatore dhe jo aktivitetet me karakter politik, ku kryetari në datën e postimit, në faqen personale është konfirmuar si kandidat i një force politike. Pra kryetari i bashkisë ndjek axhendën e tij si figurë politike dhe kjo nuk përfshihet në raportimet e aktiviteteve të bashkisë të cilat zhvillohen sipas regjistrimit të planifikuar të aktiviteteve sipas Kodit Zgjedhor. Transmetimi i këtij aktiviteti nuk është promovuar në faqen personale të Bashkisë Dimal, por në faqen zyrtare të vetë kandidatit si figurë politike. Nga provat që disponojmë është qartësisht e verifikueshme që ky aktivitet nuk është organizuar nga Bashkia Dimal, por nga struktura partiake të kandidatit dhe kjo duket edhe në mosparashikimin e tij dhe në raportimin në faqen e KQZ-së 5 ditë përpara planifikimit. Siç vihet re dhe në postimin në faqen personale të kandidatit për kryetar bashkie edhe njëherë e citoj, nuk kemi të bëjmë me një organizim nga Bashkia Dimal por me të drejtën e tij për

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

të marrë pjesë në aktivitete elektorale si figurë politike, e cila është qartësisht e ndarë nga detyra e tij funksionale, e cila organizohet me pjesëmarrës të institucionit dhe lista publike për punët e kryeara, problematikat e banorëve të territorit administrativ të 4 njësi administrative të Bashkisë Dimal. Për sa më lart citojmë dhe paraqesim kundërshtimi tonë duke e cituar që ky aktivitet është cilësuar si aktivitet me karakter personal e vetë kryetarit të bashkisë dhe për këtë arsye nuk është respektuar rregulli i raportimit të aktivitetit. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Pra, ju jeni duke thënë që ai ka qenë një aktivitet elektoral, në cilësinë e kandidatit si kryetar bashkie dhe nuk është një aktivitet publik institucional i kryetarit të bashkisë ose e Bashkisë Dimal. Për këtë arsye nuk është raportuar në KQZ.

Znj. Rajmonda Shukra, Sekretare e Përgjithshme e Bashkisë Dimal: Po.

Z. I. Celibashi: Mund t'ju bëj një pyetje, kush kanë qenë pjesëmarrësit në këtë aktivitet?

Znj. Rajmonda Shukra, Sekretare e Përgjithshme e Bashkisë Dimal: Pjesëmarrësit në këtë aktivitet kanë qenë anëtarë të shtabeve elektorale të kandidates. Nuk ka patur pjesëmarrës të administratës së bashkisë apo forca të tjera të cilat janë të privuara nga vendimi KQZ-së. Ky aktivitet është zhvilluar pas orarit zyrtar të punës, pasi kandidati është konfirmuar si subjekt nga një forcë politike si kandidat i Partisë Socialiste.

Z. I. Celibashi: Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

Rajmonda Shukra, Sekretare e Përgjithshme e Bashkisë Dimal: Faleminderit juve!

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e organizatave, parti politike për të diskutuar në lidhje me këtë... nuk ka. Mirë faleminderit! Vazhdojmë me raportimet.

Znj. I. Osmanaj: Në vijim të relatimit për këtë periudhë raportimi kemi administruar tre denoncime për mosraportim të veprimtarive publike nga institucioni i Bashkisë Belsh përkatësisht të regjistruar me numër regjistri 294 ID, 302 dhe 303 ID. Objekti i këtyre denoncimeve ka të bëjë me takimin e kryetarit të Bashkisë Belsh me banorë të Gjolenës për të diskutuar mbi projektet e ardhshme 4 vjeçare. Takimi i dytë është takim me banorë të zonës së Rrasës së Poshtme dhe takimi i tretë ka të bëjë me takimin e kryetarit të Bashkisë Belsh me banorë të fshatit Lisaj. Në kuadër të procedurës administrative kemi dërguar kërkesë për informacion personit përgjegjës për Bashkinë Belsh, por nuk i është përgjigjur kërkesës sonë për informacion. I kemi thirrur për të marrë pjesë në seancën e sotme publike por rezulton që nuk janë paraqitur. Në vijim kemi Bashkinë Elbasan. Është denoncuar për një veprimtari publike të paraportuar, të regjistruar me numër regjistri 300 ID. Objekti i këtij denoncimi ka të bëjë me takimin e Kryetarit të Bashkisë Elbasan me banorë të zonës së Baltës. Kemi dërguar kërkesë për informacion personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike por nuk kemi marrë një përgjigje. I kemi thirrur për të marrë pjesë në seancën e sotme publike, por rezulton se nuk janë paraqitur. Bashkia Mallakastër është denoncuar për dy veprimtari publike të paraportuara, të regjistruara me nr. Regjistri 295 dhe 300 ID. Denoncimi sërisht është përcjellë nga KRIIK-u. Objekti i këtyre denoncimeve ka të bëjë me inspektimin e punimeve për rikonstruksionin e muzeut të qytetit të qytetit të Ballshit. Takimi i dytë ka të bëjë me

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

inspektimin e punimeve për rikonstrukcionin dhe asfaltimin e disa rrugëve në fshatin Dukat nga Kryetari i Bashkisë zoti Qerim Ismailaj. Në kuadër të procedurës administrative i kemi dërguar kërkesën për informacion personit përgjegjës për Bashkinë Mallakastër. Nuk kemi administruar pretendime. I kemi thirrur për të marrë pjesë në seancën e sotme publike, por rezultoi që nuk janë paraqitur. Kemi Bashkinë Himarë, denoncuar për një veprimtari publike të paraportuar e regjistruar me numër regjistri 299 ID. Objekti i kësaj veprimtarie ka të bëjë me takimin e kryetarit të Bashkisë Himarë zotit Goro me banorë të fshatit Pilur që jetojnë e punojnë prej vitesh në Greqi. Denoncuesi pretendon se ky aktivitet është transmetuar edhe në media lokale. Në kuadër të procedurës kemi dërguar kërkesë për informacion dhe pretendimet e bashkisë Himarë janë si më poshtë vijon: “Ky takim nuk është organizuar nga Bashkia Himarë, por është në vijim të takimeve që zhvillohen herë pas here nga Partia Socialiste me komunitetin përkrahës të saj në Greqi. Duke mos patur dijeni për takimin, nuk kemi raportuar. Sjellim në vëmendje të KQZ-së se Kryetari i Bashkisë Himarë, zoti Goro nuk mund të udhëtojë drejt shtetit Grek.” I kemi thirrur palët për të marrë pjesë në seancën e sotme por rezultoi që nuk janë paraqitur. Bashkia Fusharrëz denoncohet për një veprimtari publike të paraportuar, regjistruar me numër regjistri 304 ID. Objekti i kësaj veprimtarie është aktivitet ceremonial me rastin e dorëzimit të titullit “Qytetare Nderi” pas vdekjes familjarëve të zotit Saliko në mjediset e Qendrës Kulturore të Fëmijëve. Kemi dërguar kërkesë për informacion personit përgjegjës për Bashkinë Fusharrëz. Nuk kemi administruar pretendime. Janë thirrur për të marrë pjesë në seancën e sotme publike, por nuk janë paraqitur. Kemi administruar denoncimin ndaj Bashkisë Tiranë për një veprimtari publike të paraportuar, regjistruar me numër regjistri 306 ID. Objekti i këtij denoncimi është inaugurimi i xhamisë së re “Mahmut Vrapi” në njësinë numër 2. Në kuadër të procedurës kemi dërguar kërkesën për informacion personit

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

përgjegjës për Bashkinë Tiranë. Nuk kemi administruar pretendime. Janë thirrur në seancën e sotme për të marrë pjesë, për të dhënë shpjegimet e tyre për sa i takon këtij denoncimi, por rezulton që ky përfaqësues nuk është paraqitur. Kemi Bashkinë Shkodër, denoncuar për një veprimtarie publike të paraportuar, regjistruar me numër regjistri 314 ID. objekt i kësaj veprimtarie denoncimi është takimi i Kryetarit të Bashkisë, zotit Bardh Spahia me pedagog dhe student të universitetit “Luigj Gurakuqi”, duke shprehur kënaqësinë që disa pedagog janë edhe kandidat për këshillin bashkiak. Kemi vijuar hetimin administrativ duke i dërguar kërkesë për informacion personit përgjegjës për Bashkinë Shkodër. Pretendimet janë si më poshtë vijon: “Aktiviteti i raportuar është një aktivitet i pasqyruar vetëm në faqen personale të zotit Bardh Spahia, nuk ka patur pjesëmarrje tjetër përveç disa banorëve. I kemi thirrur në seancën e sotme publike për të dhënë shpjegimet e tyre përfundimtare, por rezulton që palët nuk janë paraqitur në këtë proces administrativ. Kemi Bashkinë Berat denoncuar për një veprimtari të zhvilluar përpara datës së raportuar, regjistruar me numër 322 ID. Objekt i këtij denoncimi është takimi është takimi i Kryetarit të Bashkisë zotit Demo dhe drejtuesit politik të Qarkut Berat zoti Blendi Çuçi me pensionistë dhe banorë në njësinë administrative Velebisht. Ky aktivitet është publikuar në faqen e Kryetarit të Bashkisë Berat dhe të zotit Çuçi në datën 9 prill. Aktiviteti i raportuar në ndërfaqen e KQZ-së është raportuar për tu zhvilluar në datën 10 prill. Kemi vijuar hetimin administrativ duke i dërguar kërkesë për informacion personit përgjegjës për komunikim në Bashkinë Berat. Pretendimet e palëve janë se Bashkia Berat ka raportuar në datën 5 prill një takim me pensionistë dhe banorë në njësinë administrative të planifikuar për tu zhvilluar në datën 10 prill, i cili nuk është zhvilluar për arsye sepse drejtuesit politik dhe kandidati zoti Demo kishin planifikuar një takim tjetër elektoral në këtë njësi. Theksojmë se në takimin e rradhës në 9 prill nuk ka patur pjesëmarrje nga stafi i bashkisë dhe prandaj është

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

respektuar ky detyrim. I kemi thirrur palët për të marrë pjesë në seancën e sotme publike, por rezulton që palët në këtë proces administrativ nuk janë paraqitur.

Z. I. Celibashi: I referojmë edhe të tjerat.

Znj. I. Osmanaj: Viojmë me denoncimet e tjera që kanë të bëjnë kryesisht me përrurimin e burimeve publike dhe aseteve publike. Kemi denoncimin ndaj Bashkisë Vlorë për një veprimtari për përdorim të burimeve publike, regjistruar me numër regjistri 229 ID. Palët në këtë proces janë Organizata Qytetare ndaj Bashkisë Vlorë. Objekti këtij denoncimi është aktiviteti i deputetit Blendi Klosi me të rinj votues për herë të parë në qytetin e Vlorës. Takimi është zhvilluar në ambjentet e kinemasë së qytetit dhe është i postuar në rrjetin e tij social në datën 1 mars. Nga denoncimi pretendohet se të rinjtë kanë qenë të detyruar për të marrë pjesë në këtë aktivitet. Në kuadër të procesit të hetimit administrativ kemi kërkuar informacion nga personi përgjegjës për Bashkinë Vlorë sikurse dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë. Nga zyra vendore kemi administruar pretendimet ku bëhet me dije se Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar nuk ka dijeni në lidhje me zhvillimin e këtij aktiviteti dhe pjesëmarrësit në të.

*Zbardi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

Znj. I. Osmanaj: Zyra vendore apo drejtoritë e institucioneve arsimore nuk është paraqitur asnjë ftesë nga këto subjekte. Të gjitha institucionet arsimore që janë në varësi të Zyrës Vendore Arsimore Vlorë-Himarë, janë njohur me aktet ligjore/nënligjore në fuqi të cilat ndalojnë përdorimin e detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar, për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve. Kemi njoftuar palër për të marrë pjesë në këtë proces dhe behet me dije se organizata Qëndresa Qytetare është paraqitur për të dhënë shpjegimet e saj përfundimtare sa i takon këtij denoncimi.

Z. I. Celibashi: Kemi raportime për institucione të tjera?

Znj. I. Osmanaj: Po!

Z. I. Celibashi: I referojmë të gjitha dhe pastaj t'i japim përfaqësuesve të organizatave dhe përfaqësuesve të partive.

Znj. I. Osmanaj: Janë për bashki të ndryshme?!

Z. I. Celibashi: Po le të jenë. Meqenëse janë në një rend dite... apo doni të bëjmë pak pushim?

Znj. I. Osmanaj: Jo, Jo! Bashkia Kukës ka denoncuar dy veprimtari me përdorim të burimeve publike, regjistruar me numër regjistri 335 dhe 336 ID. Denoncuesi është Qëndresa Qytetare. Objektet e këtyre denoncimeve janë: Takimi i zhvilluar

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

në ambientet e shkollës “Isuf Seferi” në fshatin e njësisë administrative Grykë Çajë, e kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Kuksit njëherazi edhe Kryetar i Bashkisë zoti Safet Gjiçi dhe zonjës Dallëndyshe Bici, Drejtore e Përgjithshme e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës me banorë të zonës. Takimi i kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Kuksit njëherazi edhe Kryetar i Bashkisë zoti Safet Gjici dhe zonjës Dallëndyshe Bici Drejtore e Përgjithshme e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës për një takim të dytë të zhvilluar në ambientet e jashtme të shkollës 9- vjeçare “Shaban Murati”, në Lus me banorë të zonës. Pasi kemi administruar denoncimin kemi dërguar kërkesën për informacion palëve në këtë proces. Pretendimet nga Bashkia Kukës nuk kemi administruar ndërkohe kemi administruar pretendimet e Qëndresës Qytetare të cilat do i paraqesi edhe në këtë seancë publike.

Kemi denoncim për Këshillin e Ministrave për veprimtari që kanë të bëjnë me nxjerrjen e një akti nënligjor, regjistruar me numër regjistri 337 ID. Sërisht ky denoncim është përcjellë nga Qëndresa Qytetare. Objekti është miratimi i aktit që ka të bëj me shpërblimin e pensionistëve për vitin 2023 nga ana e Këshillit të Ministrave, në datën 31 mars 2023. Pretendimet e Qëndresës Qytetare është se miratimi i këtij vendimi është në shkelje të Kodit Zgjedhor, që ndalon nxjerrjen e akteve të tilla që parashikojnë dhëniën e përfitimeve për kategori të caktuara jo më afër se 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve. Kemi dërguar kërkesë për informacion edhe Këshillit të Ministrave por nuk kemi administruar përgjigje. I kemi njoftuar palët për të marrë pjesë në këtë proces, rezulton se vetem organizata Qëndresa Qytetare është paraqitur në këtë proces administrativ.

Kemi denoncim për Bashkinë Vlorë, regjistruar me numër regjistri 338 ID. Denoncuesi është Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i cili ka denoncuar një veprimtari që ka të bëj me takim me gra sipërmarrëze në qytetin e Vlorës e organizuar nga

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

Partia Socialiste, dega Vlorë. Komiteti Shqiptar i Helsinkit pretendon se ky takim është mbajtur në orën 12:00, njëkohësisht që pjesëmarrëz kanë qenë punonjës të institucioneve vendore të bashkisë si Drejtoria e Tatimeve, Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor si dhe institucione të tjera duke përdorur në këtë mënyrë administratën shtetërore në fushatë zgjedhore. Në kuadër të procesit administrativ kemi kërkuar informacion nga Bashkia Vlorë, nga Drejtoria e Tatimeve, Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor në lidhje me këtë çështje, objekt denoncimi. Nuk kemi administruar përgjigje. Janë njoftuar për të marrë pjesë në seancën e sotme publike por rezulton se vetëm Komiteti Shqiptar i Helsinkit është paraqitur ndërsa institucionet e tjera të denoncuara nuk janë paraqitur.

Kemi denoncimin për Bashkinë Berat, për një veprimtari publike me pjesëmarrjen e deputetit si dhe përdorimi i sloganeve zgjedhore regjistruar me numër regjistri 324 ID. Ky denoncim është përcjellë nga KRIIK-u. Objekt i këtij denoncimi ka të bëjë: takim me banorët e zonës në lidhje me projektin e kësaj zone. Me pjesëmarrjen e Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtuesit Politik të qarkut Berat, njëkohësisht edhe Ministër i Brendshëm zotit Çuçi. Ky takim është publikuar në faqen zyrtare të kryetarit të bashkisë si dhe në rrjetet sociale të zotit Blendi Çuçi. Aktiviteti është organizuar nga Bashkia Berat, qartazi është përdorur për diskutime elektorale dhe premtime të drejtpërdrejta në funksion të zgjedhjeve të datës 14 maj 2023. Aktiviteti është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së në datën 5 prill për tu zhvilluar në datën 10 prill ndërkohë publikimet mbajnë datën 9 prill. Në raportimin e aktivitetit nuk përmendet pjesëmarrja e drejtuesit politik të qarkut zoti Çuçi dhe as i deputetit Fadil Nasufi që ishte i pranishëm. Në kuadër të procesit administrativ kemi dërguar kërkesë për informacion Bashkisë Berat e cila ndër të tjera na bën me dije se: Bashkia Berat ka raportuar në datën 5 prill për një takim me pensionistat dhe banorë në njësinë administrative të planifikuar për në datën 10 prill i cili nuk

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,
Dt.26.04.2023*

është zhvilluar për arsye se drejtuesi politik zoti Çuçi kishte planifikuar një takim me karakter elektoral në këtë njësi. Nga tërësia e problematikave që u trajtuan një pjesë e mirë u ezaurua në këtë takim elektoral të organizuar nga Partia Socialiste për këtë arsye, por edhe për faktin e axhenda e kryetarit të bashkisë njëherazi edhe kandidat është shumë e ngjeshur. Takimi i planifikuar për të nesërmen është anuluar. Theksojmë se në takimin e datës 9 nuk ka patur pjesëmarrës nga stafi bashkisë duke respektuar në këtë mënyrë të gjitha detyrimet ligjore. Palët në proces janë njoftuar për të marrë pjesë për të dhënë shpjegimet e tyre përfundimtare por nuk janë paraqitur.

Gjithashtu kemi denoncimet të regjistruara me numër regjistri 327, 328, 329, 330, 331, 332, 333, 334 ID nga subjektet zgjedhore përkatësisht Partia Demokratike të cilat kanë të bëjnë me publikim në media i Ministrit të Mbrojtjes zoti Niko Peleshi duke bërë promovimin e rritjes së pagës për ushtarakët dhe rekrutimin në forcat e armatosura. Denoncimi i dytë ka të bëjë me publikimin në media të Kryetarit të Bashkisë Cërrik dhe drejtuesit politik zotit Gjijnuri në fshatin Shalës duke promovuar përdorimin e burimeve publike gjatë fushatës zgjedhore. Takimi i tretë ka të bëjë me publikimin në faqen e facebook-ut të zotit Bujar Dema, pjesë e strukturave të policisë së shtetit, një status ku promovon punën e Kryetarit të Bashkisë Krujë i cili është njëkohësisht edhe kandidat. Takimi i katërt ka të bëjë me shpërndarjen e formularëve nga administrata shtetërore për punëmarrësit që duhet të plotësojnë ato me qëllim votimi të denoncuar dhe të publikuara në media nga zoti Ylli Manjani. Takimi i pestë ka të bëjë me shpërndarjen e ndihmave ushqimore tek banorët nga persona me uniformë policie dhe promovimin në faqen zyrtare facebook të Bashkisë Lezhë. Aktiviteti i gjashtë ka të bëjë me një ceremoni ndarje certifikata për stafin e ZVA-së Dibër, me pjesëmarrjen e zonjës Balluku dhe drejtuesit të zyrës arsimore vendore Dibër. Takimi i shtatë ka të bëjë me

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

promovimin e projektit të moleve që po realizohen në kohë fushate zgjedhore në Shirokë, me pjesëmarrjen e zonjës Elisa Spiropali si dhe kreut të Fondit Shqipëtar të Zhvillimit zotit Dritan Agolli dhe kandidati i Partisë Socialiste për Bashkinë Shkodër zotit Bened Bici. Takimi i fundit ka të bëjë me shpërndarjen e ndihmave ushqimore për banorët e Hasit nga djali i kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë Has me punonjës shtetëror dhe me automjete në pronësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit. Për këto denoncime jemi ende në fazën e shqyrtimit. Kemi dërguar kërkesa për informacion dhe jemi ende në pritje të respektimit të afateve procedurale për të administruar përgjigjet e këtyre institucioneve, objekt denoncimi.

Z. I. Celibashi: Kjo ishte lista e të gjithë institucioneve?

Znj. I. Osmanaj: Po!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit. Atëherë përfaqësuesit e partive, përfaqësuesit e organizatave, Qendresa Qytetare dhe Komiteti Shqipëtar i Helsinkit... Po nga institucionet? Fjala për ju fillimisht.

Z. L. Lila: Përshëndetje zoti Komisioner. Ledia Lila nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, personi relatues pranë Komisionit Qendror për këtë institucion. Ashtu sikurse ju kemi raportuar edhe në ditën e djeshme përmes emailit dëshirojmë tju informojmë se në lidhje me pretendimet e organizatës Qëndresa Qytetare në lidhje me prezencën e zonjës Dallëndyshe Bici, me detyrë funksionale si Drejtoreshë e Përgjithshme Pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, ditën e dielë me datë 16 pranë njësisë administrative në Grykë Çaj. Mund t'ju themi se prezenca e zonjës

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

Dallëndyshe Bici në këtë takim nuk lidhet me detyrën e saj funksionale, si drejtuese institucioni, por i një vizitë pranë miqve dhe familjarëve të saj duke qenë se zonja Bici është me origjinë nga kjo zonë. Pikërisht vjen nga fshati, Fshat ku është organizuar edhe takimi. Ky takim mund të konsiderohet si një takim privat i saj i cili është organizuar jasht orarit zyrtar të punës. Mund të themi që në këtë takim nuk është përdorur asnjë aset që lidhet me detyrat funksionale të institucionit. Nuk është bërë pasqyrimi i këtij aktiviteti në faqet që promovojnë punën e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës as në faqet e saj personale. Nuk janë përdorur as logot e institucionit. Si rrjedhojë prandaj nuk është bërë asnjë raportim i këtij aktiviteti nga Agjencia Shtetërore duke mos e konsideruar si një aktivitet të institucionit tonë. Ndaj do ju lutesha edhe njëherë që të merret në konsideratë raportimi i bërë nga ana jonë duke bërë edhe njëherë shqyrtimin dhe shpresoq mirkuptimin tuaj.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i Qëndresa Qytetare?

Z. Dh. Zguro: Dhimitër Zguro, përfaqësues i Qendresës Qytetare. Në datën 16 prill 2023 në ambjentet e një shkolle që është shkollë e fshatit, Fshat, njësia administrative Grykë Çaj është zhvilluar një takim elektorale me praninë e zotit Safet Gjici dhe me praninë e Drejtoreshës së Përgjithshme të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës. Ku të dy kanë bërë thirrje dhe veçanërisht zonja Dallëndyshe Bici ka bërë thirrje për mbështetjen e kandidatit të Partisë Socialiste. Duke u shprehur si në këtë takim gjithashtu edhe në takimin tjetër “kam ardhur këtu me bekimin e Kryeministrit për të mbështetur njeriun e punës”. Përsa i takon pretendimeve që mund të lidhen me faktin që po vizitojmë familjarët... Unë me origjinë jam nga Korça por nuk është që sa herë shkoj në Korçë dal krah kandidatit të një partie

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

politike edhe të bëj thirrje për votimin e një partie të caktuar politike dhe nuk është se mbështes një subjekt të caktuar politik. Vizitat familjare unë nuk besoj se pasqyrohen nëpër media apo në aktivitetet e kandidatve dhe subjekteve zgjedhore në zgjedhjet e 14 majit. Prania e zonjës Dallëndyshe Bici është një veprimtari... Së pari njëherë kemi të bëjmë me një veprimtari të ndaluar sepse zhvillohet në ambjentet e një shkolle 9 vjeçare. Prania e zonjës Dallëndyshe Bici është e ndaluar sepse në referim të pikës 2, të nenit 3, të vendimit numër 9, të vitit 2020 drejtorët e përgjithshëm të drejtorive në varësi të Kryeministrit apo Ministrive të tjera e kanë të ndaluar të marrin pjesë në këto veprimtari të ndaluara dhe aq më tepër e kanë të ndaluar të bëjnë thirrje për tu votuar një subjekt i caktuar politik dhe për të orientuar votuesit në një mënyrë të caktuar. Për më tepër që zonja Dallëndyshe Bici në këtë aktivitet ndër të tjera shprehet se, të paktën tek video e zbardhur nga ana e Qëndresës Qytetare, në sekuençën nga minuta 1:23 deri në minutën 2:17 shprehet “ kështu nëqoftëse votat tuaja do të jenë për Partinë Socialiste dhe për kryetarin e palodhur Safetin edhe investimet do të jenë më të mëdhaja. Prandaj të gjithë të punojmë bashkë, ti japim krahët njëriut të punës, ti japim krahët njëriut më të mirë. Jo për të fituar, sepse është e sigurt por për të patur një fitore të sigurt”. Unë nuk mendoj se këto deklaratime apo deklaratime të tjera të zonjës Dallëndyshe Bici, prania e saj, sloganet e Partisë Socialiste, prania e këngës elektorale që Partia Socialiste ka zgjedhur mund të lidhem me ndonjë vizitë me familjarët, në dijeninë time. Logjika nuk ma thotë që është një vizitë tek familjarët përderisa të gjithë njerëzit i takojnë familjarët e tyre po nuk i ndodh shpesh që të marrin pjesë nëpër aktivitete politike gjatë vizitave tek familjarët. Ndërkohë përse i përket pjesës së raportimit, i qëndrojmë të gjitha pretendimeve në të njëjtën kohë siç i kemi parashtruar në ankim edhe besojmë që qoftë zonja Dallëndyshe Bici apo qoftë zoti Safet Gjici, qoftë edhe Partia Socialiste si subjekt përfitues i këtyre burimeve

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

publike duhet të ndëshkohen më nivelin maksimal nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit. Ju po thoni që, në cilësinë që ka zonja Bici nuk do të duhet të kishte marrë pjesë në atë lloj aktiviteti, së pari?

Z. Dh. Zguro: Po! Zonja Bici nuk duhet të merrte fare pjesë në një aktivitet elektoral qoftë për shkak të cilësisë së saj.

Z. I. Celibashi: Sipas gjetjeve apo vlerësimit tuaj ai ka qenë një aktivitet politik dhe elektoral dhe ju thoni se ajo për cilësitë dhe funksionin që ka nuk mundet të marrë pjesë në një aktivitet të tillë.

Z. Dh. Zguro: Jo vetëm sipas gjetjeve tona por edhe sipas provave është e qartë që në takimin elektoral janë përdorur sloganet e Partisë Socialiste, PS përpara, mbrapa, unë votoj punën, unë votoj Safet Gjicin kështu që është një takim i qartë elektoral dhe në ambjentet e një shkolle, që është ambjent publik.

Z. I. Celibashi: Po pra e kemi të qartë! Pra thjesht për ta përbledhur. Ju thoni që ai ka qenë një aktivitet politik dhe elektoral?

Z. Dh. Zguro: Po!

Z. I. Celibashi: Në të cilin ka marrë pjesë Drejtuesja e ASHK-së dhe në vlerësimin tuaj nuk duhet të kishte marrë pjesë dhe nuk do të duhet të kishte përcjellë mesazhe

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

elektorale në këtë takim. Sepse ju thoni ka marë pjesë edhe thoni që ka prezantuar thirrje elektorale dhe mbështetje për një kandidat.

Z. Dh. Zguro: Po!

Z. I. Celibashi: Gjë që për ju është në kundërshtim me ligjin.

Z. Dh. Zguro: Po, dhe për më tepër është zhvilluar në një vend që nuk duhet të zhvillohej farë, siç është një shkollë.

Z. I. Celibashi: Edhe aktiviteti është zhvilluar në një institucion publik ku nuk do të duhej të zhvillohej për shkak të natyrës që kishte ky aktivitet. E qartë. Faleminderit! Po, përfaqësuesja e ASHK-së.

Z. L. Lika: Zoti Komisioner, ndoshta biem edhe ne dakord, që një aktivitet nuk duhet të ishte organizuar në këtë ambient. Mirpo nuk mund të marrim përgjegjësi për një aktivitet që nuk e ka organizuar (gjithmon do flas personalisht) zonja Bici pasi e ritheksoj që ky aktivitet nuk lidhet me detyrat funksionale apo me detyrën e zonjës Bici. Në këtë aktivitet nuk është bërë asnjë premtim elektorale për ç'ka mund të ketë zonja Bici si drejtuese e ASHK-së në dorë si shpërndarje e titujve të pronësisë. Nuk i di raportet personale që ka zotëria sipas gjykimit të vet por nuk mund të gjykojmë zonjën pse ka shkuar ka bërë një vizitë në qytetin e saj dhe rastësisht qëllon një aktivitet i organizuar në të cilën ajo merr pjesë.

Z. I. Celibashi: Tregoi si qëndron në raport me ligjin sjellja e drejtueses, nuk mu duk sikur kishte ndonjëgjë personale.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

Z. Dh. Zguro: Raportin për të cilin fola ashtu sikurse edhe Komisioneri theksoi. Unë nuk e njoh fare zonjën dhe nuk më ka rënë rasti ta takoj. Unë e kisha në raport të zonjës me ligjin. Pra i vetmi raport për të cilin unë shqetësohem është, sa zonja e respekton ligjin në veprimtarinë e saj. Po bëja një analogji për faktin se Agjencia Shtetërore e Kadastrës pretendon se, dakord zonja po shkonte të takonte familjarët e vet. Të gjithë i takojmë familjarët por nuk marrim pjesë në aktivitete politike, aq më tepër kur është një dretuese dhe e ka theksuar edhe vet në video, “që kam drejtuar institucione mjaft të larta dhe kam bashkëpunuar qoftë me kryetar bashkish të djathtë po nuk më ka rënë rasti të njoh njeri si Safet Gjici që shqetësohet për hallet e popullit” dhe thirrje të tjera elektorale. Qatësisht është një aktivitet i natyrës elektorale, politike ku zonja Bici nuk duhet të merrte pjesë, në cilësinë e funksionares që ka.

Z. I. Celibashi: Po edhe njëherë dhe besoj do të jetë e fundit.

Z. L. Lika: Atëhere, për ç’ka ka thënë zonja Bici që ka bashkëpunuar me titullar të institucioneve të ndryshme, kjo mund të them që vjen edhe për shkak të detyrës funksionale që ka pasur sidomos në institucionet e fundit që ajo drejton.

Z. I. Celibashi: Qartë. Kemi ndonjë diskutim tjetër? Qoftë edhe për çështje të tjera të cilat u relatuan. Qoftë Qëndresa, qoftë Komiteti Shqipëtar i Helsinkit. Përfaqësues të institucioneve të tjera nuk kemi nga këto të cilat... dëgjojmë edhe përfaqësuesin e Bashkisë Fushë Arrëz se ndoshta mund të keni edhe ju një gjykim për atë. Ju jeni mos gaboju?

*Zbardhi materialin audio
Jonq DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

Z. S. Leshi: Po

Z. I. Celibashi: Nuk e di njëri prej jush, kush do ta përfaqësojë. Të lutem mund të vish aty para tek mikrofonit?

Z. S. Leshi: Jam Sajmir Lleshi, Bashkia Fushë Arrëz, nëpunës civil specialist i ujit të kullimit, ujitjes dhe bujqësisë. Nga ana e bashkisë jemi vënë në dijeni në lidhje me një kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pra një ankimim që ka bërë një subjekt lidhur me dhënien e një titulli nderi. Pasi kemi marrë informacione nga ana juaj, ne kemi kthyer një përgjigje të cilën e kemi nisur edhe në mënyrë elektronike dhe me postë, në datën 18.04.2023, me numër protokolli 1160. Në përgjigjen tonë kemi sqaruar se veprimtaria është bërë me datë 06.04.2023 por është hedhur një javë me vonesë në profilin zyrtar të bashkisë për arsye të lejes vjetore të specialistit përkatës që mbulon komunikimin publik. Vendimi i këshillit të Bashkisë Fushë Arrëz për dhënien e titullit qytetar nderi i përket datës 30.11.2022. Por duke qenë se familjarët e tij nuk janë banorë të zonës, pasi janë nga jugu i Shqipërisë, është shtyrë ceremonia e akordimit dhe organizimit të ceremonisë soleme. Për arsye të organizimit të brendshëm para dy javësh është caktuar një person tjetër si kordinator me KQZ-në dhe për pasojë nuk është bërë raportimi i veprimtarisë në faqen e KQZ-së nga ana e bashkisë. Përsa më sipër ne kërkojmë mirkuptimin tuaj dhe theksojmë që në vijim do të jemi të vëmendshëm dhe korrekt ndaj detyrimeve ligjore.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Faleminderit edhe për gjestin e përfilljes edhe formalisht të ftesës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që në kontraditë me institucione të tjera të cilat janë vetëm 100 metër larg institucionit të KQZ-së nuk e

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

kanë bërë edhe pse kjo nuk i bën këto gjeste të sanksionueshme nga pikpamja formale por gjithsesi vlerësojmë respektin. Jam i sigurtë që edhe organizata që ka prezantuar këtë denoncim KRIIK e vlerëson. Faleminderit. Kemi të tjera? Po vazhdojmë më përfaqësues të...

Z. Dh. Zguro: Në lidhje me çështje të rendit të ditës, sapo jemi informuar që sot pjesë e rendit të ditës do të ishte edhe kallëzimi që në kemi bërë për çështjen e shpërblimit të pagave, ndërkohë që për këto çështje do të kërkonim shtyrjen sepse sapo jemi njoftuar. Për çështjen që lidhet me Bashkinë e Vlorës për përdorimin e aseteve publike nga ana e zyrtarëve të Partisë Socialiste. Jo vetëm deputetit Blendi Klosi por disa deputetëve të Partisë Socialiste në këtë qark, duke përfshirë këtu edhe Zëvendës Ministren e Turizmit zonjën Vilma Bello, mos gabohem. Në këtë denoncim ne kemi pretenduar dhe i qëndrojmë denoncimit tonë duke qenë se vetë Partia Socialiste ka përdorur burime shtetërore sic janë burimet e teatrit. Pavarësisht se ka interpretim të ndryshëm nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ne besojmë se lista është strikte përsa i përket ndalimit të përdorimit të burimeve shtetërore. Për aq kohë sa nuk kemi një rregullim të ndryshëm nga ligjvënësi apo nga organi rregullator siç është Komisioni Rregullator pranë KQZ-së, kërkojmë konstatimin e përdorimit të burimeve publike sepse është qartazi një aktivitet i zhvilluar nga Partia Socialiste. Janë bërë thirrje për votimin e Partisë Socialiste, janë përdorur sipas denoncimeve të cilat na kanë ardhur në adresën tonë edhe burime njerëzore që lidhen edhe me përdorimin e gjimnazistëve të cilët janë edhe votues për herë të parë në Bashkinë e Vlorës. Për të gjitha këto arsye që relatova tani por edhe për të gjitha arsyet e tjera që kemi prezantuar në ankimin tonë, kërkojmë edhe sanksionimin e të gjithë personave përgjegjës. Faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Dakord, përfaqësues të Komitetit të Helsinkit?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

Z. E. Maçolli: I nderuar Komisioner. Erdion Maçolli, avokat, përfaqësues i Komitetit Shqipëtar të Helsinkit. Ne kemi përcjellë pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve sinjalizimin tonë për një aktivitet të zhvilluar në Bashkinë e Vlorës. Aktiviteti është zhvilluar në datën 3 mars 2023 e cila është një ditë zyrtare pune dhe ky aktivitet është zhvilluar në një subjekt privat por tema e tij ka qenë gruaja në sipërmarrje, rruga drejt fuqizimit të sipërmarrjes dhe roli i grave në këtë proces. Organizator i këtij procesi është Partia Socialiste e Shqipërisë dhe ora e organizimit të këtij aktiviteti ka qenë orë zyrtare pune, ora 12:00. Kjo verifikuar edhe në ftesat përkatëse të shpërndara për këtë aktivitet të cilat ne i kemi përcjellë në cilësinë e provës. Ajo ç'ka ne kërkojmë të theksojmë dhe ngrejmë me shqetësim është se pjesëmarrëz në këtë takim janë përfaqësues të niveleve të ndryshme të institucioneve shtetërore dhe të administratës publike. Të tillë si Bashkia e Vlorës, Drejtoria e Tatimeve, Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor etj... Jemi përballë rastit, ku në vlerësimin tonë jemi në keqpërdorim të burimeve publike në mbështetje dhe për interes të një subjekti zgjedhor. Në këtë rast jemi konkretisht përball faktit të përdorimit të burimeve publike të cilat ndalohen nga neni 91, pika 2 e Kodit Zgjedhor. Po ashtu ndalohen edhe nga neni 3, pika 1.1.3 gërma ç e vendimit numër 9 sepse kemi përdorim të detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore dhe brenda orarit zyrtar. Gjithashtu kemi edhe shkelje të nenit 6, pika 3 të këtij vendimi i cili përcakton se punonjësit e administratës shtetërore gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore ndalohet çdo pjesëmarrje dhe veprimtari me karakter politik. Kjo ka qenë një veprimtari me karakter politik. Kjo verifikohet edhe nga ftesa e cila është shpërndarë për këtë aktivitet e cila përmbante logot e subjektit zgjedhor. Në këto kushte ne nuk kemi bërë identifikimin e personave pjesëmarrëz. Kemi vlerësuar së nuk është në detyrën dhe nuk është e nevojshme që një organizatë e shoqërisë

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

civile të ndalet dhe të identifikojë me emra konkret se cilët janë punonjësit shtetëror. Ndaj kemi vlerësuar se ka qenë i mjaftueshëm vetëm përcjellja e këtij sinjalizimi pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i cili ka dhe kompetencat e duhura për të bërë verifikimin duke marë edhe informacion zyrtar përballë institucioneve të ndryshme shtetërore. Ashtu sikundër nga përfaqësuesit e administratës tuaj u relatua se është kërkuar informacion zyrtar por që nuk kemi pasur një përgjigje zyrtare. Në interpretim edhe të mosreagimit nga institucionet shtetërore ne vlerësojmë se tashmë ata kanë pasur mundësinë për të mohuar këtë pretendim dhe fakti që nuk kanë vepruar dhe kanë zgjedhur të heshtin për të dhënë një informacion të thjeshtë është një elementi i rëndësishëm i cili tregon bazueshmëri faktike të kësaj ankese të Komitetit Shqipëtar të Helsinkit drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Lidhur me këtë ne konkludojmë dhe kërkojmë marrjen e masave administrative nga ana juaj. Faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po përfaqësuesi i koalicionit Bashkë Fitojmë.

Z. F. Nuri: Po, faleminderit i nderuar zoti Komisioner. Unë do të bëj një ndërhyrje duke u nisur nga rastet konkrete. Së pari në vija të përgjithshme i falenderoj organizatat që kanë kryer denoncime dhe që vazhdojnë të kryejnë denoncime të tjera. Ne si subjekt politik kemi bërë denoncime online qoftë edhe denoncime me shkresë apo edhe drejtuar Prokurorisë, do vazhdojmë ti bëjmë këto. Por konstatimi i përgjithshëm është që shohim çdo ditë që ka një keqpërdorim të administratës kudo në Shqipëri. Jo vetëm në rastin e Kukësit që e denoncuam këtu apo rastin e Vlorës apo raste të tjera që u relatuan por ne konstatojmë çdo ditë raportime të përdorimeve sidomos të administratës në nivele drejtoreshë, përgjegjësish dhe më lartë ku janë të angazhuar në terren të gjithë. Ajo që na shqetëson është fakti se kur

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

kapen në flagrancë po themi justifikohen me arsye nga më të ndryshmet, vizita familjare, jemi me leje, jashtë orarit të punës, dihet që këto janë thjesht justifikime ne do të kërkojmë sanksionimet e të gjitha këtyre rasteve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sipas parashikimeve administrative dhe ligjore. Po sanksionimet ju lutem të jenë maksimale dhe jo sanksionime si disa që kanë dal edhe në media të tipit 2500 lek të vjetra për shembull për Bashkinë e Lushnjës. Sanksionime të cilat as nuk e inkurajojnë zbatimin e ligjit por përkundrazi. Gjithashtu shpreh keqardhjen time sepse në vitin 2023 të vazhdohet akoma të përdoret administrata për qëllime elektorale si në zgjedhje të shkuara ku ka pasur probleme me zgjedhjet në Shqipëri. Faleminderit.

Z. I. Celibashi: Kemi diskutime të tjera lidhur me këtë pikë të rendit të ditës? Nuk kemi. Mirë, faleminderit të gjithë kontributorëve me diskutime në këtë pikë të rendit të ditës.

Vendimi nr.416

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

26.04.2023
Ora 13:15

RENDI I DITËS

Shqyrtimi i denoncimit me nr. 386 ID të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për vendosje materiali propogandistik në Bashkitë Rrogozhinë, Kavajë, Lushnje, Durrës.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:** Z. Ilirjan Celibashi
- **Stafi KQZ:** Z. Y.Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. I. Osmanaj, Z. E. Meta,
Znj. V. Ballgjini,
- **Parti Politike:** Bashkë Fitojmë (F.Nuri)
- **Të tjerë:** KRIIK, OSBE ODIHR,
Qëndresa Qytetare, Komiteti Shqipëtar
I Helsinkit

Z. I. Celibashi: Atëherë kalojmë tek pika e tretë që ka të bëjë me shqyrtimin e denoncimit 386 të KRIIK ndaj Partisë Socialiste për vendosjen e materialit propagandistik në Bashkinë Rrogozhinë, Kavajë, Lushnje dhe Durrës.

Znj. V. Ballgjini: Po! Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar denoncimi me numër 386 ID datë 24.04.2023 nga organizata KRIIK. Ku sipas denoncimit janë evidentuar: Billborder të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë në afërsi të akseve kombëtare Tiranë-Lushnje dhe më specifikisht në akset kombëtare në Bashkitë Lushnje, Rrogozhinë, Kavajë dhe Durrës. KRIIK

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

konstaton se këto materiale propagandistike janë afishuar të gjitha në kundërshtim me Kodin Zgjedhor. Gjithashtu materialet propagandistike të vendosura nuk kanë shënimin “prodhuar në përgjegjësinë ligjore të (emri i subjektit zgjedhor)”. Bashkia Rrogozhinë nuk e ka publikuar në faqen e insternetit vendimin e marrë prej kryetarit të bashkisë për të përcaktuar vendet e afishimit të materialeve propagandistike për subjektet zgjedhore. Bashkia Durrës e ka marrë dhe publikuar vendimin pasi ka nisur fushata zgjedhore, më saktësisht në datën 19 prill 2023. Përsa i përket pikës së parë lidhur me billboarderat të cilat janë vendosur në aksin rrugorë kombëtar Tiranë-Lushnje Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka caktuar monitoruesit që i përkasin këtyre bashkive për verifikimin e materialeve propagandistike të vendosura nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Jemi akoma në proces verifikimi dhe përsa i përket pikave të tjera për të cilat ngre pretendimet organizata KRIIK do i referoheshim seancës së datës 25 prill 2023. Ku Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ju la afat kohor bashkive, kryetarëve të bashkive dhe subjekteve zgjedhore që subjektet zgjedhore brenda datës 28 prill të vendosin të gjithë materialet propagandistike shënimin “prodhuar në përgjegjësinë ligjore të (emri i subjektit zgjedhor)” si dhe kryetarëve të bashkive që brenda dy ditëve të dërgojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve listën e vendeve të lejuara për afishimin e materialeve propagandistike për fushatë zgjedhore. Kjo listë dhe vendimi përkatës për caktimin e lëtyre vendeve duhet të publikohet menjëherë në faqen elektronike të bashkive.

Z. I. Celibashi: Diskutime në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës? Nuk kemi! Dakord. Në lidhje me këtë natyrë çështje ne dje morëm vendim që ti detyrojmë brenda një afati dy ditorë të gjitha subjektet që të vendosin shënimin që tregon përgjegjësia e kujt është për prodhimin dhe vendosjen e këtyre materialeve

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.26.04.2023*

propagandistike. Ndërkohë ju kemi dërguar një shkresë kryetarve të bashkive që do të duhet ta kuptojnë ndryshe urdhërimin e Kodit Zgjedhor për caktimin e vendeve ku do të vendosen materialet propagandistike. Do të duhet ti caktojnë fizikisht dhe konkretisht, pasi nga pikëpamja rregullatore këtë e ka bërë Kodi Zgjedhor dhe aktet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Dakord, mirë.

E përfundojmë edhe këtë pikë dhe ashtu sikurse për pikën e parë të rendit të ditës do të vlerësojmë shpjegimet që u dhanë këtu në seancë edhe dokumentacioni që deri më tani zotëron Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për denoncimet e bëra por edhe për gjetjet që kemi bërë ne si institucion. Përfshi këtu dhe rastin e denoncimit të findit 386 të KRIIK ndaj subjektit zgjedhor Partia Socialiste për vendosjen e materialeve propagandistikë në Bashkitë Rrogozhinë, Kavajë, Lushnje dhe Durrës dhe do të disponojmë me vendim në një nga seancat e ardhshme. Ndërkohë denoncimin specifik të Qëndresa Qytetare ndaj Këshillit të Ministrave për vendimin për rritjen e pensioneve me kërkesë të Qëndresës do ta shqyrtojmë në një ditë tjetër. Dakord?! Kemi përfunduar në fakt sepse pika e katërt e rendit të ditës që lidhet me denoncimin e Partisë Socialiste kundër Koalicionit Bashkë Fitojmë për vendosjen e materialeve propagandistik në Kavajë do të shtyhet për ditën e nesërme, kur të jetë edhe përfaqësuesi i Partisë Socialiste meqënëse nuk është sot dhe ka kërkuar që të jetë në shqyrtimin e këtij denoncimi. Nëse nuk kemi gjë tjetër përfundojmë. Faleminderit, ditë të mbarë të gjithëve!

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

